- shto/fshi rreshta të tjerë nëse nevojitet.

Ne autorizojmë autoritetin kontraktor të verifikojë informacionin e dhënë në këtë tabelë.

**PERSONI I KONTAKTIT (për këtë ofertë)**

**Emri:**

**Adresa:**

**Nr. Telefonit:**

**Faks:**

**E-mail:**

**Nënshkrimi**

**Vula**



**Shtojca 11**

*(Shtojcë për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik)*

**DEKLARATË MBI KONTRATAT E LIDHURA DHE/ OSE NE PROCËS<sup>4</sup>**

Deklaratë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit që do të zhvillohet në datë \_\_\_\_\_ nga Autoriteti Kontraktor \_\_\_\_\_ me objekt \_\_\_\_\_ me fond limit \_\_\_\_\_.

Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_ me cilësinë \_\_\_\_\_ të operatorit ekonomik \_\_\_\_\_ deklaroj se kam në proces dhe/ose jam shpallur fitues për kontratat e mëposhtme:

<b>Nr.</b>	<b>Autoriteti kontraktor</b>	<b>Objekti i procedurës se prokurimi/kontratës</b>	<b>Vlera e shpallur fituese</b>

**Data e dorëzimit të deklaratës** \_\_\_\_\_

**Përfaqësuesi i ofertuesit**

**Nënshkrimi**

**Vula**

**Shënim:** Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili prej anëtarëve të bashkimit duhet të plotësojë këtë deklaratë.

---

<sup>4</sup> Kjo deklaratë ka si qëllim plotësimin e kriterit ligjor që operatori ekonomik brenda së njëjtës periudhë nuk është kontraktor/nënkontraktor për kontratë/kontrata të lidhura dhe/ose është shpallur fitues, me vlerë të përbashkët ose të veçantë, më të madhe se 100 % i kufirit maksimal, që disponon, sipas licencës profesionale, të lëshuar nga autoriteti kompetent

## Shtojca 12

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

### 1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PRANIMIT/KUALIFIKIMIT

Ofertuesi duhet të deklarojë se:

- a) Është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.
- b) nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv)
- c) nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP,
- ç) nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.
- d) ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

Edhe Ofertuesi i huaj duhet të deklarojë se i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër nëpërmjet paraqitjes së një vetëdeklarate me shkrim.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vetëdeklaratën e lartpërmendur.

**Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet kontraktore.**

**Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 8.**

**Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.**

**Veç kësaj, nëse oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, duhet të dorëzohen:**

- a. Marrëveshja e noterizuar sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht;
- b. Prokura e posaçme.

## 2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Përshkrimin e Ofertës, sipas Shtojcës 1;
- b. Deklaratë për paraqitje oferte të pavarur, sipas Shtojcës 1/1;
- c. Sigurim oferte, (nëse është e zbatueshme) sipas Shtojcës 3;
- ç. Deklaratë mbi përmbushjen e Specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 5;
- d. Deklaratë mbi Konfliktin e Interesit sipas Shtojcës 7;
- dh. Deklaratë mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës Shtojcës 8/1;
- e. Formular vlerësimi sipas Shtojcës 9;
- f. Deklaratë mbi disponueshmërinë e mjeteve sipas Shtojcës 10;
- g. Deklaratë mbi kontratat e lidhura apo ne proces, sipas Shtojcës 11;
- gj. Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

### 2.1. Per kapacitetin ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë:

Sipas kriterëve të përgjithshme të kualifikimit.

### 2.2 Per kapacitetin ekonomik dhe financiar:

a. Xhiro mesatare e realizuar nga Operatori Ekonomik gjatë tre viteve të fundit (2017, 2018 dhe 2019) duhet të mos jete jo me e vogel se 50 % e fondit limit. Per te vertetuar plotesimin e ketij kushti Operatori Ekonomik duhet te paraqese nje vërtetim nga Dega e Tatim Taksave për xhiron vjetore të realizuar në 3 (tre) vitet e fundit.

b. Operatori Ekonomik duhet të ketë një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm gjatë tre viteve 2017, 2018 dhe 2019. Per te vertetuar plotesimin e ketij kushti Operatori Ekonomik duhet te paraqese kopje të bilanceve të këtyre tre viteve, të paraqitura e konfirmuara nga autoriteti përkatës, të shoqeruara nga akt ekspertizë e kryer nga Eksperti kontabel i autorizuar nëpërputhje me ligjin anr.10091 datë 5.3.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesi tligjor dhe kontabilistit të miratuar”

c. Operatori Ekonomik duhet të paraqese një deklaratë me shkrim nga administratori se subjekti ka paguar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në vendet ku operatori ka ushtruar apo ushtron aktivitet për periudhën vitet 2018, 2019 dhe keestet e maturuara të vitit 2020 sipas afateve të percaktuara në ligjin 9632/2006 ” Per sistemin e taksave vendore ”, i ndryshuar. Kesaj deklarate duhet ti bashkengjiten te gjithë vertetimet qe deshmojne se operatori ekonomik **ka paguar detyrimet perkatese**, në vendet ku ka ushtruar apo ushtron aktivitet për këte periudhë.

**Autoriteti Kontraktor rezervon te drejten te verifikojë vertetesine e informacionit te paraqitur. Ne rast deklarimi te rreme do te veprohet ne perputhje me nenin 13, pika 3, germa "a" te Ligjit Nr.9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, "Per Prokurimin Publik".**

### **2.3 Per kapacitetin teknik:**

#### **2.3.1**Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:

- a) Punë të ngjashme e realizuar ne një kontrate te vetme ne nje vlere jo me e vogel se 50 % e fondit limit, te realizuar gjatë tri viteve të fundit ku zerat e punimeve respektive plotesojne kriteret minimale te preventivit te objektit ne prokurim.

*Ose*

- a) punë të ngjashme deri ne nje kufi ku vlere monetare totale e kontratave te punëve të kryera e marrë së bashku gjatë tre viteve të fundit është në një vlerë sa dyfishi e vleres se fondit limit dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit,ku zerat e punimeve respektive ploteojne kriteret minimale te preventivit te objektit ne prokurim.

Plotesimi i njerit prej dy kushteve te siperpermendura e ben oferten te kualifikueshme.

**2.3.1/a**Për kontrata të realizuara me autoritete publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Formularin e vleresimit
2. Kontratën/Kontratrat
3. Kontrata e bashkepunimit ndermjet B.O.E\*
4. Situacionin përfundimtar;
5. Aktin e kolaudimit;
6. Çertifikaten/certifikatat e marrjes ne dorezim.
7. Faturat tatimore perkatese per cdo situacion

\*Pika 3 "Kontrata e bashkepunimit ndermjet B.O.E" eshte e detyrueshme per tu paraqitur vetem per kontratat qe jane realizuar si bashkim operatoresh ekonomik. Mos paraqitja e kontrates se kerkuar do te jete shkak skualifikimi.

**2.3.1/b**Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Formularin e vleresimit
2. Kontrate;
3. Lejen e ndertimit
4. Situacionin përfundimtar;
5. Aktkolaudim i objekti;
6. Çertifikaten e marrjes ne dorezim te objektit;
7. Fatura tatimore per cdo situacion punimesh.

*Pika 2.3.1/a plotësohet nga anëtarë i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 2.3.1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.*

**2.3.2** Operatoret ekonomike duhet te deshmojne se disponojne license profesonale per zbatim punimesh ne ndertim si dhe per kategorite e nevojshme per zbatimin e kontrates.

Per kete duhet te paraqesin licensen perkate se te shoqerise, bazuar neformatin e miratuar me Vendim te Keshillit te Ministrave Nr. 42 date 16.01.2008; *Per miratimin e rregullores per kriteret dhe Procedurat e dhenies se licensave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te Subjekteve juridike qe ushtrojne veprimtari ndertimi*”, I ndryshuar.

**Licenca lidhur me ekzekutimin e punimeve:**

1. License per zbatim punimesh pikat NP.2 -*Klasifikimi "B"*
2. License per zbatim punimesh pikat NP.11 -*Klasifikimi "A"*
3. License per zbatim punimesh pikat NS.1 -*Klasifikimi "A"*
4. License per zbatim punimesh pikat NS.2- *Klasifikimi "B"*
5. License per zbatim punimesh pikat NS.4 -*Klasifikimi "A"*
6. License per zbatim punimesh pikat NS.8 -*Klasifikimi "A"*
7. License per zbatim punimesh pikat NS.9 -*Klasifikimi "A"*
8. License per zbatim punimesh pikat NS.10-*Klasifikimi "A"*
9. License per zbatim punimesh pikat NS.12 -*Klasifikimi "A"*
10. License per zbatim punimesh pikat NS.13 -*Klasifikimi "A"*
11. License per zbatim punimesh pikat NS.14 -*Klasifikimi "A"*

Sipas modelit të lëshuar nga MPPT/MTI/MEI apo Ministria kompetente e linjes ;

**3. Shoqëritë e huaja duhet te kene kryer ekuivalentimin ( njehsimin ) e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Transportit dhe Infrastruktures, Republika e Shqipërisë, sic percaktohet ne *Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te subjekteve juridike qe ushtrojne veprimtari ndertimi, e miratuar me VKM Nr.42, date 16.01.2008.***

**4. Deshmi per fuqine mesatare punetore te operatorit ekonomik:**

**Per te provuar se ka pervoje e duhur , Operatori duhet te deshmoje se ka te punesuar mesatarisht të paktën 100 (*njeqind*) punonjes, me kohe te plote,për periudhën **Janar 2020---Nentor 2020** të deshmuar me;**

**a. Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj ne periudhen e mesiperme .**

**b. List pagesat e punonjesve te plotesuar rregullisht sipas formatit e percaktimeve qe kerkohe nga legjislacioni ne fuqi per secilin nga muajt ne periudhen e mesiperme.**

**b-Pjese e stafit te shoqerise dhe te figuroje ne Licensen e kompanise :**

Inxhinier Ndertimi	1 (nje)
Arkitekt	1 (nje)
Inxhinier Elektronik	1(nje)

## Dokumenta Standarde të Tenderit

Inxhinier Mjedisi	1 (nje)
Inxhinier Elektrik	1 (nje)
Inxhinier Hidroteknik	1 (nje)
Inxhinier Gjeodet	1 (nje)
Inxhinier Mekanik	1 (nje)

Secili prej pjestarëve të drejtuesve teknik të mësipërm, duhet të jetë në **Listëpagesat te pakten per periudhen Janar 2020--- Nentor 2020** si dhe të figurojnë në **licensën e shoqërisë**.

Per secilin prej pjesëtareve të stafit duhet të paraqitet:

- **kontratë noteriale pune e vlefshme**
- **diploma**
- **libreze**
- **cv**

c- Operatori ekonomik ofertues Krahas stafit të mesiperm të kete të punësuar staf mbeshitetes si me poshte:

- Inxhinier Ndertimi Profili Strukturiste
- Inxhinier Telekomunikacioni
- Teknik ndertimi – 3
- Teknik Gjeometer -1
- Teknik Topograf -1
- Teknik Mekanik -2
- Specialist hidraulik – 1
- Specialist Elektracist – 1
- Specialist Pllakashtrues – 1
- Specialist per ndihmen e pare - 1

Operatori ekonomik per Inxhinier Ndertimi Profili Strukturiste, Inxhinier Telekomunikacioni paraqes , kontrate noteriale pune, diplome , dhe të jene ne liste pagesen e shoqeris **per periudhen Janar 2020--- Dhjetor 2020**.

Operatori ekonomik per Tekniket , Specialist te paraqes e mesiperm kontratat noteriale te punes, Deshmia e kualifikimit/ certifikate dhe/ose diploma e cila te jete e leshuar nga institucione te shteterore dhe të jene ne liste pagesen e shoqeris per **per periudhen Janar 2020--- Dhjetor 2020**.

e.Operatoriekonomik ofertues duhet të ketë pjesë të stafit të punësuar, të vërtetuar me kontratë noteriale pune të vlefshme, Urdhër mjeku, diplomë, libreze pune,cv dhe të figurojë në listëpagesat e shoqerise per periudhen e kerkuar **1 (një) mjek të përgjithshëm**.

g.Të ketë në stafin e punonjesve **32(tridhjete e dy)** punonjës të pajisur me deshmi kualifikimit e sigurimit teknik nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente të akredituara sipas legjislacionit ne fuqi si dhe dëshmi të kualifikimit profesional/diploma/certifikata trajnimi ku nga këta të jenë të paktën.

- Specialist Saldator - 1

## Dokumenta Standarde të Tenderit

- Specialist Murator - 3
- Specialist Bojaxhi - 2
- Specialist Hekurkthyes - 2
- Specialist ndertimi - 2
- Specialist Hidroizolues - 1
- Specialist Karpertier - 3
- Specialist per Punime durale - 2
- Specialist Hidraulik - 2
- Specialist Suvatues - 4
- Automakinist - 2
- Shofer - 4

*Për punonjësit e sipërpërmendur të paraqiten, certifikate ose diplome dhe dëshmitë e kualifikimit të sigurimit teknik, dëshmitë e aftësisë profesionale (automakiniste, Eskavatorist me goma dhe zinxhir), lejet e drejtimit për shoferet, si dhe kontratat noteriale të punës të vlefshme. Specialistet e mesiperm duhet të figurojnë në listepagesat e shoqërisë për periudhën 3 muajt e fundit.*

h. Operatori ekonomik të kete të punësuar një eksperi zjarrefikse të shoqëruar me : kontrate noteriale pune, certifikatën e zjarrefikst, librezë pune, cv, të jete në liste pagesa për periudhën e kerkuar në dst, gjithashtu operatori ekonomik ose eksperti zjarrefikse të jete të i pajisur me Kodi 1.2.A leshuar nga QKL.

i. Inxhinier – Auditues energjie 1 person (i pajisur me “Certifikate për auditimin e energjisë) Për inxhinierin e efikasitës së energjisë duhet të kete këto dokumenta provues:  
 -Kontrata noteriale e punës (e vlefshme për të pakten periudhën e parashikuar të ndertimit),  
 -Të kete diplome universitare profili inxhinier Ndertimi.  
 -Certifikata (Dip) për efikasitën e energjisë të jete në listepagesën e kerkuar në dst.

j. Operatori për të plotësuar këto kushte duhet të kete të pakten:

-5 (Pesë) Punonjës Specialist të Certifikuar dhe trajnuar për Punimet në lartësi.D.P.I. Renia nga lartësitë, punime në fasade, etj sipas V.K.M nr.312 datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier” e dhënë nga një organizatë certifikimi e akredituar shqiptar ose e huaj. Të jete me kontrate noteriale pune individuale dhe të figurojnë në Listepagesat për të pakten e kerkuar në dst

### **1. Disponimi i mjeteve të mëposhtme:**

Kamion vetëshkarkues, kapacitet mbajtes 15-18 ton	copë 2 (dy)	Ne pronesi ose me qera
Kamioncine vetëshkarkues,kapacitet mbajtes 1500-2000 kg	copë 1 (nje)	Ne pronesi ose me qera
Kamioncine, kapacitet mbajtes 1000-1400 kg	copë 2 (dy)	Ne pronesi ose me qera
Autovinxh	copë 2 (dy)	Ne pronesi ose me qera
Eskavator me goma	copë 1 (nje)	Ne pronesi ose me qera
Minieskavator	copë 1 (nje)	Ne pronesi ose me qera
Kamion me vinc kapacitet mbajtes 6.5 - 8.5 ton	copë 2 (dy)	Ne pronesi ose me qera
Autovinc me krah horizontal mbi 40 ml (shoqëruar me	copë 1 (nje)	Ne pronesi ose me qera

Dokumenta Standarde të Tenderit

skede teknike)		
Kantier ndertimi (zyre)	copë 1 (nje)	Ne pronesi ose me qera
Rimorkiator	copë 1 (nje)	Ne pronesi ose me qera
Skela	M2 2500	Ne pronesi ose me qera
Autobetoniere	copë 1 (tre)	Ne pronesi ose me qera
Autopompe betoni	copë 1 (nje)	Ne pronesi ose me qera
Panele armature betonimi	M2 (600)	Ne pronesi ose me qera
Vibrator betoni	copë 2 (dy)	Ne pronesi ose me qera
Prerese Pllakash	copë 2 (dy)	Ne pronesi ose me qera
Pompe Suvatimi	copë 2 (dy)	Ne pronesi ose me qera
Betoniere kantier	copë 2 (dy)	Ne pronesi ose me qera
Disk prerese inoxi	cope 120	Ne pronesi ose me qera
Cekic te ndryshem	cope 6	Ne pronesi ose me qera
Zmeriluese	cope 5	Ne pronesi ose me qera
Punto	cope 5	Ne pronesi ose me qera
ElektroGur	cope 1	Ne pronesi ose me qera
Matrapik Betoni	cope 1	Ne pronesi ose me qera
Pompe suvatimi	cope 4	Ne pronesi ose me qera
Shkalle Alumini	cope 4	Ne pronesi ose me qera
Kokore Sigurie	Cope 100	Ne pronesi ose me qera
Jelek Pune	cope 40	Ne pronesi ose me qera
Fikese Zjarri	cope 5	Ne pronesi ose me qera
Rripa Sigurimi	cope 5	Ne pronesi ose me qera
Tabela Sigurimi Teknik	20 Copë	Ne pronesi ose me qera
Kuti Ndhme e shpejt	10 Copë	Ne pronesi ose me qera
Element sinjalistike	10 Copë	Ne pronesi ose me qera
Prozhektor per ndricim	2 Copë	Ne pronesi ose me qera

5.

6.

7.

8. Per te deshmuar kete, Formulari i shtojces 9 te DSTduhet te shoqerohet me dokumentat e meposhtme:

9.

- Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronesi, duhet të paraqitet dokumentacioni që vertetojnë pronesinë e mjetit:
  - certifikaten e pronesisë;
  - leja e qarkullimit;
  - certifikaten e kontrollit teknik;
  - siguracionin;
  - taksat vjetore
  - leja e transportit dhe fotot perkatese;
 ndersa per mjete te marra me qera krahas dokumentacionit te mesiperem, duhet te paraqitet edhe kontrata e qerese e cila duhet te jete e vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te punimeve deri ne perfundimin e plote te punimeve.



## Dokumenta Standarde të Tenderit

- Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes apo çdoganimit, fotot dhe fatura tatimore perkatese, ndërsa për mjete të marra me qera krahas dokumentacionit të mesipër, duhet të paraqitet edhe kontrata e qerave e cila duhet të përfshijë objektin perkates dhe duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të punimeve deri në përfundimin e plotë të punimeve.

Për mjetet dhe pajisjet e tjera që nuk pajisen me leje qarkullimi, ofertuesi duhet të paraqesë kontratë materiale të blerjes ose fatura tatimore të blerjes ose dokument zhdoganimi të mjetit

Deklaratë nga administratori i shoqërisë që merr përsipër me shpenzimet e veta dhe është dakort që të paraqesi pranë AK mjetet dhe pajisjet e kërkuara më sipër, në rast se do të lindin nevojat për verifikimin e tyre, përpara shpalljes së klasifikimit.

Deklaratë me shkrim nga administratori i shoqërisë mbi vendodhjen e mjeteve.

### **10. Në rast bashkimi operatorësh ekonomik, secili prej tyre duhet të jetë i pajisur me certifikatat e siperpermendura.**

Grafiku i punimeve, ku zërat e punës, fuqisë punëtore dhe numrit të mjeteve të jetë në përputhje me afatin kohor në dokumentet e tenderit.

OE duhet të paraqesë kontratë furnizimi për tubo PVC, plastike sipas preventivit, kontrata e tubove të jetë e shoqëruar me kontratë furnizimi, katalogun, ISO 9001-2008, të dhënat teknike, makineritë e prodhimit të tubove, QKB, certifikata e cilësive së provës, KODI III.1.B (riciklim plastik), KODI III.1.A (prodhimi I produkteve plastike), KODI III.2.B (përpunimi I plastikes).

Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruara sipas shtojcës Nr. 10. Deklaratë nga administrator i shoqërisë ofertuese.

### **Deklaratë nga administratori i shoqërisë që informacioni dhe dokumentet e paraqitura në tender janë të sakta dhe nuk përmbajnë informacion të rreme, për penalizim konform parashikimeve të nenit 13 të LPP.**

Operatori ekonomik i këtyre Licencave për Stacion Transformimi për mbetje jo të rrezikshme (stacionimin dhe dheravën sipas germimit) Kodi III.1.A në mbështetje të vendimit të Këshillit të Ministrave VKM Nr. 419, Datë 25/6/2014 dhe Ligj Nr. 104448, Datë 9/6/2011.

Operatori ekonomik pjesëmarrës në tender së bashku me preventivin duhet të dorëzojë analizë teknike për të gjithë zërat e preventivit të ofertës. Mosparaqitja në formën e kërkuar përbën kusht për skualifikim. Bazuar në VKM Nr. 514, datë 15.8.2007, "Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit", pika 10.

Cdo ofertues do të paraqesë PLANIN E SIGURISË NE KANTIER Per punimet ne objekt ne format sipas VKM nr. 692 date 13.12.2001 "Per masat e vecanta te sigurimit dhe ruajtjes se shendetit ne pune, te ndryshuar me VKM nr. 742 date 06.11.2003. sipas kërkesës, si rrethimi provizor, depozitimi i materialeve kryesore, ambientet e kantierit, rrugë kalimet, tabelat e sig. teknik etj.

## Dokumenta Standarde të Tenderit

Operatori ekonomik duhet te kete kontrate noteriale me nje laborator testimi te betonit, i cili duhet te jete i akredituar nga organizma kombetar ose nderkombetar sipas standarteve SSH EN 12390-3:2009, SSH EN 12504-4:2008, SSH EN 12350-2:2009 dhe SSH EN 12504-2:2012.

Operatori ekonomik duhet te kete licence lidhur me ndikimin ne mjedis te leshuar nga QKL. Kodi III.2.A (1+2) ne mbeshtje te vendimit te Keshillit te Ministrave Ligj Nr. 10431, Date 9/6/2011, VKM Nr. 538, Date 26/5/2009, VKM Nr. 1124, Date 30/7/2008.

Operatori ekonomik duhet te kete licence lidhur me ndikimin ne mjedis te leshuar nga QKL. Kodi III.1.A ne mbeshtje te vendimit te Keshillit te Ministrave VKM Nr. 419, Date 25/6/2014 dhe Ligj Nr. 104448, Date 9/6/2011.

Operatori ekonomik duhet te kete licence lidhur me ndikimin ne mjedis te leshuar nga QKL. Kodi III.2.B autoriteti kontraktor kërkon që kjo të kryhet në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe konkretisht në ligjin 10081 datë 23.02.2003 , nga ku rrjedhimisht operatorët ekonomik ofertes duhet të disponojnë licencë QKL III.2.B “ Grumbullim, Transportim, Ruajtje, e mbetjeve Urbane”.

Ne perputhje me specifikimet teknike si dhe preventivit perkates, operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim/kontrate bashkepunimi nga prodhuesi/distributori, me të cilin prodhuesi/distributori autorizon kompaninë pjesëmarrëse në tender të ofertojë këto pajisje/mallra në këtë procedurë prokurimi, si më poshtë.

- Hidroizoluese;
- Bojra hidroplastike;
- Pajisje hidraulike;
- Pasjisje elektrike;
- Pllaka;
- Kondicionimin

Për rastin kur autorizimi do të jetë lëshuar nga distributori i autorizuar, duhet te shoqerohet edhe me dokumentacionin qe verteton lidhjet e firmes prodhuese me distributorin (kontratë/autorizim). Operatori ekonomik të paraqesë katalogjet perkatese per secilin nga produktet/mallrat e mesiperme. Gjithashtu O.E. te paraqes deklarate garancie jo me pak se 1 vit nga momenti i marrjes ne dorezim.

Vetëdeklarim nga operatori ekonomik që brenda së njëjtës periudhë nuk është kontraktor/nëkontraktor për kontratë/kontrata të lidhura, me vlerë të përbashkët ose të veçantë, jo më të madhe se 100 % i kufirit maksimal, që disponon kandidati, sipas licencës profesionale, të lëshuar nga autoriteti kompetent. Në kuptim të përcaktimit të mësipërm, fjala “*periudhë*” nënkupton kohëzgjatjen e investimit të kryer sipas LPP-së nga çasti i shpalljes fitues e deri në kolaudimin e objektit/investimit”<sup>5</sup>.

## Dokumenta Standarde të Tenderit

Vetedeklarim nga operatori ekonomik pjesmarres per kontratat që ka në proces dhe\ose eshte shpallur fitues, duke percaktuar objektin, vleren e kontrates, si dhe drejtuesin teknik te deklaruar per secilin objekt qe ka proces dhe\ose eshte shpallur fitues. Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili prej anëtarëve të bashkimit duhet të plotësojë këtë deklaratë.

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

### Shtojca 13

*(Shtojcë për t'u plotësuar nga autoriteti kontraktor)*

#### **PROJEKTI I ZBATIMIT DHE SPECIFIKIMET TEKNIKE**

**Përshkrimi i të dhënave teknike të punëve objekt prokurimi** të përshkruara sa më saktë dhe në mënyrë të plotë, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara.

#### **KUJDES**

Specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë markë apo emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët “ose ekuivalent” të përfshihen detyrimisht në këto specifikime.

Skicimet, Planimetritë e Objektivit etj:

Specifikimet Teknike të Materialeve:

Grafiku i Punimeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

**Shtojca 14**

*(Shtojcë për t'u plotësuar nga autoriteti kontraktor)*

**PREVENTIVAT E PUNIMEVE**

**Shtojca 15**

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

**NJOFTIM STANDART PËR OFERTUESIN E SKUALIFIKUAR<sup>6</sup>**

[Vendi dhe data]

[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

[Adresa e ofertuesit]

I/E Nderuar Z. /Zj. <emri i kontaktit>

Ju falenderoj për pjesëmarrjen në procedurën e lartpërmendur të prokurimit publik. Procedura e kryer në përputhje me Ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006 Për Prokurimin Publik.

Oferta juaj u vlerësua me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e ofertës. Me keqardhje ju informoj se u s'kualifikuat, sepse oferta e dorëzuar nga ju u refuzua për shkak të arsyes (-ve) së/të mëposhtme:

---

---

---

---

Nëse mendoni se Autoriteti Kontraktor ka shkelur LPP ose RrPP gjatë procedurës së prokurimit publik, atëherë keni të drejtë të filloni një procedurë rishikimi siç parashikohet në Kreun VII të LPP-së.

Edhe pse nuk mundëm të përdornim shërbimet tuaja në këtë rast, besoj se do të vazhdoni të jeni i interesuar në nismat tona të prokurimit.

Me respekt  
< **Emri** >

---

<sup>6</sup> Ky njoftim duhet të përdoret në rastin e procedurave të prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore

## Shtojca 16

[ Shtojcë për t'u plotësuar Autoriteti Kontraktor]

### FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

[Data\_\_\_\_\_]

Për: [Emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]

Procedura e prokurimit:

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [Sasia ose qëllimi dhe kohëzgjatja e kontratës]

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët  oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. \_\_\_\_\_

*Emri i plotë i shoqërisë*

*numri i NIPT-it*

Vlera \_\_\_\_\_

*(me numra dhe fjalë)*

2. \_\_\_\_\_

*Emri i plotë i shoqërisë*

*numri i NIPT-it*

Vlera \_\_\_\_\_

*(me numra dhe fjalë)*

Etj. \_\_\_\_\_

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. \_\_\_\_\_

*Emri i plotë i shoqërisë*

*numri i NIPT-it*

2. \_\_\_\_\_

*Emri i plotë i shoqërisë*

*numri i NIPT-it*

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues] se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej [shuma përkatëse e

## Dokumenta Standarde të Tenderit

*shprehur në fjalë dhe shifra*]/pikët totale të marra [\_\_\_\_\_]është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [*emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit*] sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda \_\_\_\_\_ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [*vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra*], siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë \_\_\_\_\_

Ankesa: ka ose jo \_\_\_\_\_

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë \_\_\_\_\_

[Titullari i autoritetit kontraktor]



## Shtojca 17

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në rastin e marrëveshjes kuadër]

### FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË MARRËVESHJEN KUADËR

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e operatorëve ekonomikë të shpallur fitues]

1. \_\_\_\_\_

2. \_\_\_\_\_

3. \_\_\_\_\_

\* \* \*

Procedura e prokurimit: \_\_\_\_\_

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[Sasia, objekti, kohëzgjatja e kontratës etj]*

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:  oferta ekonomikisht më e favorshme  çmimi më i ulët

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë, me shumatorën e çmimeve për njësi të ofruar/ me vlerat përkatëse të ofruara:

1. \_\_\_\_\_

*Emri i plotë i shoqërisë*

*numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera \_\_\_\_\_

*(me numra dhe fjalë)*

2. \_\_\_\_\_

*Emri i plotë i shoqërisë*

*numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera \_\_\_\_\_

*(me numra dhe fjalë)*

Etj. \_\_\_\_\_

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:

1. \_\_\_\_\_

*Emri i plotë i shoqërisë*

*numri i NIPT-it*

2. \_\_\_\_\_

Dokumenta Standarde të Tenderit

*Emri i plotë i shoqërisë*

*numri i NIPT-it*

Perkatësisht për arsyet e mëposhtme:

---

---

---

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se janë identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm:

1. \_\_\_\_\_ / \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera \_\_\_\_\_ / Pikët totale të marra \_\_\_\_\_  
(me numra dhe fjalë)

2. \_\_\_\_\_ / \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera \_\_\_\_\_ / Pikët totale të marra \_\_\_\_\_  
(me numra dhe fjalë)

Etj. \_\_\_\_\_

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë [emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit], brenda \_\_\_\_\_ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marrëveshjen.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë \_\_\_\_\_

Ankesa: ka ose jo \_\_\_\_\_  
(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë \_\_\_\_\_

**[Titullari i autoritetit kontraktor]**

## Shtojca 18

### **KUSHTET E PËRGJITHSHME TË KONTRATËS Punët – Procedura e Hapur**

#### **Neni 1: Qëllimi**

- 1.1 Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për kryerjen e Punëve të prokuruarra ne bazë të legjislacionit të prokurimit.
- 1.2 Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Shqipërisë parashikon se dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat e prokurimit publik. Disa dispozita të Kodit Civil janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.
- 1.3 Në mënyrë të ngjashme, disa dispozita të Ligjit mbi Prokurimin Publik janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon prokurimin publik. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Ligjit mbi Prokurimin Publik mbi të drejtat, detyrat dhe detyrimet e palëve.
- 1.4 KPK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lënë mënjanë kushtet ose dispozitat e parashikuara në pjesë të tjera të kontratës.
- 1.5 Kushtet e kontratës përfshijnë gjithashtu Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të mbizotërojnë mbi KPK.

#### **Neni 2: Përkufizime**

- 2.1 “Preventiv total” do të thotë volumet e punes te dhena ne projekt te cilat jane orientuese, plotesuar me cmimin total të përcaktuar që është pjesë e Ofertes në një kontratë me çelsa ne dore.
- 2.2 “Preventiv per njesi” do të thotë volumet e punes te dhena ne projekt shoqeruar me cmimet per njesi te pandryshuara që janë pjesë e Ofertes në një kontratë me punime ne matje.
- 2.3 “Afati i realizimit te punimeve” do të thotë data që Punët duhet të perfundojnë siç është shprehur në Grafikon për realizimin Punimeve , e vertetuar nga enti prokurues.
- 2.4 “Kontratë” do të thotë marrëveshja e shkruar e lidhur midis Autoritetit Kontraktor dhe kontraktorit që përbëhet nga dokumentat e tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha bashkangjitjet dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.
- 2.5 “Cmim kontrate” do të thotë çmimi që i paguhet kontraktorit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontaktore.

## Dokumenta Standarde të Tenderit

- 2.6 “Realizimi i punimeve” do të thotë data e vërtetuar nga Autoriteti Kontraktor se Punët janë mbaruar.
- 2.7 “Defekt” do të thotë çdo pjesë e Punimeve e paperfunduar në përputhje me kontratën.
- 2.8 “Data e hyrjes” do të thotë data që Autoriteti Kontraktor lejon kontraktorin në kantier.
- 2.9 “Data e fillimit” është përfshirë në Të dhënat e kontrates. Ajo është data kur kontraktori do të fillojë punimet e ndertimit. Nëse kjo nuk realizohet, “data e fillimit” do të jetë dita në të cilën do të paguhet paradhënia.
- 2.10 “Pajisje” do të thotë makineritë dhe veglat e kontraktorit të sjella përkohësisht në kantier për realizimin e Ndertimeve.
- 2.11 “Materiale” do të thotë të gjitha furnizimet, duke përfshirë ato të konsumit, të përdorura nga kontraktori për kryerjen e punimeve.
- 2.12 “Objekt i kontratës” do të thotë të gjitha Punët që kontraktori do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.
- 2.13 “Palë(t)” do të thotë nënshkruesit e kontratës.
- 2.14 “Drejtues projekti” do të thotë personi i emëruar nga Autoriteti Kontraktor që është përgjegjës për administrimin e kontratës për Autoritetin Kontraktor.
- 2.15 “Autoritet Kontraktor” do të thotë Autoriteti Kontraktor që është pjesë e kësaj kontrate dhe që kontraktori punon objekt i kësaj kontrate. Ky term kudo që përdoret ka kuptim të njëjtë me atë të perkufizuar në ligj.
- 2.16 “Kantier” do të thotë vendi fizik i Punimeve.
- 2.17 “Raport i inspektimit të kantierit” do të thotë dokumentat e përfshira në dokumentat e tenderit që pasqyrojnë informacion faktik dhe të interpretuar rreth kushteve të sipërfaqes dhe nëntokës së kantierit.
- 2.18 “Nënkontraktues” do të thotë çdo person fizik ose ligjor ose kombinim i mësipërm, që furnizon Punët, materialet ose pajisjet për ose në emër të kontraktorit.
- 2.19 “Kontraktor” do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate siguron Punimet.
- 2.20 “Standarte Teknike” do të thotë specifikimet e aprovuara nga një trup i posaçëm standartizimi për zbatimin e vazhdueshëm ose të përsëritur. Standarte të tilla përdoren si rregulla, rregullore ose perkufizim të karakteristikave për të siguruar se materialet dhe shërbimet e procesuara i përgjigjen qëllimit.
- 2.21 “Ngritja e kantierit” do të thotë punimet e ndertimit të përkohshme, të ndërtuara e instaluar, që janë të nevojshme për zbatimin e punimeve të ndertimit.

- 2.22 “Punime” do të thotë ajo që Autoriteti Kontraktor i kërkon nga kontraktori të gërmojë, ndërtojë, riparojë, rinovojë ose instalojë siç parashikohet në dokumentat e tenderit duke përfshirë shërbimet në lidhje me to, gjithashtu të përkufizuara në dokumentat e tenderit.

**Neni 3: Hartimi i Kontratës**

- 3.1 Njoftimi i ofertes fituese do të shërbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të shprehur në dokumentat e tenderit.
- 3.2 Ekzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës duke sanksionuar të gjitha marrveshjet midis palëve.

**Neni 4: Praktikrat e Korrupuara, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli i Procesverbaleve**

- 4.1 Autoriteti Kontraktor mund t’i kërkojë gjykatës të deklarojë të paligjshme kontratën nëse zbulon se kontraktori ka kryer veprime të korrupuara. Veprimet e korrupuara përfshijnë veprimet e përshkuara në Nenin 26 të Ligjit mbi Prokurimin Publik.
- 4.2 Kontraktori nuk duhet të ketë lidhje (të tashme ose të shkuara) me asnjë konsulent ose ent që ka marrë pjesë në përgatitjen e dokumentave të tenderit për këtë prokurim.
- 4.3 Kontraktori duhet të lejojë Autoritetin Kontraktor të inspektojë llogaritë dhe regjistrat që kanë lidhje me zbatimin e kontratës ose t’i kontrollojë ato me anë të kontrollorëve të emëruar nga Autoriteti Kontraktor.

**Neni 5: Informacioni Konfidencial**

- 5.1 Kontraktori dhe Autoriteti Kontraktues duhet të mbajnë në konfidencë të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me kontratën.
- 5.2 Kontraktori mund t’i japë nënkontraktorit dokumenta të tilla, të dhëna ose informacione të tjera që merr nga Autoriteti Kontraktor deri në masën e kërkuar që nënkontraktorin të zbatojë punën e tij sipas kontratës. Në rast të tillë, kontraktori duhet të përfshijë në kontratën e tij me nënkontraktorin një dispozitë që premtun ruajtjen e konfidencës siç thuhet në Paragrafin 5.1 më sipër.

**Neni 6: Prona Intelektuale**

- 6.1 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruar nga kontraktori gjatë zbatimit të kontratës do t’i përkasin Autoritetit Kontraktor i cili mund t’i përdorë ato sipas gjykimit të tij.
- 6.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, kontraktori, pas përfundimit të kontratës, duhet t’i dorëzojë Autoritetit Kontraktor të gjitha raportet dhe të dhënat si hartat, diagramët, skicimet, specifikimet, planet, statistikën, llogaritjet dhe regjistrat mbështetës ose materialet e fituara, mbledhura ose përgatitura nga kontraktori gjatë zbatimit të kontratës. Kontraktori mund të mbajë kopje të këtyre dokumentave dhe të dhënave, po nuk duhet t’i përdori për qëllime që s’kanë lidhje me kontratën pa leje paraprake me shkrim nga Autoriteti Kontraktor.

- 6.3 Kontraktori duhet të garantojë Autoritetin Kontraktor zhveshjen nga përgjegjësia për shkelje të të drejtave të pronës intelektuale, që mund të dalin nga përdorimi i materialeve, skicave ose çdo prone tjetër sipas kontratës.
- 6.4 Në rast se ngrihet ndonjë pretendim ose padi kundër Autoritetit Kontraktor në lidhje me ndonjë shkelje të pronës intelektuale të shkaktuar nga zbatimi i kontratës ose nga përdorimi i materialeve, skicave ose çdo prone tjetër të mbrojtur e të furnizuar sipas kontratës, kontraktori duhet t'i japë Autoritetit Kontraktor të gjitha provat dhe informacionin në posedim të kontraktorit që kanë të bëjnë me këtë padi apo pretendim.

#### **Neni 7: Origjina e Materialeve**

- 7.1 Nuk ka asnjë kufizim për kombësinë e origjinës së materialeve, përveç atyre që mund të jenë përcaktuar në ndonjë Rezolutë të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara.
- 7.2 Kontraktori mund të jetë i detyruar të verifikojë origjinën e materialeve.
- 7.3 Për qëllime verifikimi “origjinë” do të thotë vendi ku materialet janë nxjerrë, bashkuar ose prodhuar. materialet janë prodhuar kur, nëpërmjet prodhimit, procesimit, ose mbledhjes së mjaftueshme të komponentëve, rezulton një produkt i ri i njohur në tregti që është mjaft i ndryshëm në karakteristikat bazë ose në qëllim apo përdorim nga komponentët e tij.
- 7.4 Origjina e materialeve ka dallim nga kombësia e kontraktorit ose nënkontraktorit që furnizon me materiale.

#### **Neni 8: Vendimet e Drejtuesit të Projektit**

- 8.1 Drejtuesi i projektit do të vendosë për çështjet e kontratës midis kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor
- 8.2 Drejtuesi i Projektit mund të delegojë ndonjë nga detyrat dhe përgjegjësitë e tij tek të tjerët përveç zgjidhjen e mosmarrveshjeve dhe konflikteve. Drejtuesi i projektit duhet të njoftojë kontraktorin për delegimet e bëra apo të revokuara.

#### **Neni 9: Komunikimi**

- 9.1 Çdo komunikim midis palëve duhet të bëhet me shkrim.

#### **Neni 10: Bashkëpunimi në Kantier me të Tjerët**

- 10.1 Kontraktori duhet të bashkëpunojë dhe të ndajë kantierin me firma të tjera, autoritete publike, shërbimet publike dhe Autoritetin Kontraktor siç kërkohet dhe përkufizohet në Grafikon e realizimit të punimeve.

#### **Neni 11: Përgjegjësia e Autoritetit Kontraktor**

- 11.1 Autoriteti Kontraktor ka përgjegjësi të kompensojë kontraktorin për dëmtime të pajisjeve të kontraktorit deri në masën që lidhet me veprime me faj të Autoritetit Kontraktor ose të

projekteve të Autoritetit Kontraktor me përjashtim të rastit kur keto të fundit, kishin gabime të dukshme që mund të ishin konstatuar lehtësisht nga kontraktuesi.

**Neni 12: Raporti i Inspektimit të Kantierit dhe Kushtet e Kantierit**

- 12.1 Autoriteti Kontraktor nuk mban asnjë përgjegjësi për konkluzionet ose interpretimet e bëra në raportin e inspektimit të kantierit.
- 12.2 Kontraktori pranon se i ka marrë të gjitha hapat e nevojshme për të verifikuar natyrën dhe vendin e Punimeve dhe se ka inspektuar dhe pajtohet me kushtet e përgjithshme dhe lokale që mund të ndikojnë në kryerjen ose koston e Punëve.

**Neni 13: Kontraktori që Kryen Punimet**

- 13.1 Kontraktori duhet të kryejë dhe mbarojë Punimet në përputhje me specifikimet teknike të paraqitura në dokumentat e tenderit.
- 13.2 Kontraktori nuk mban përgjegjësi për gabimet në projekt, të dhëna, planimetri ose aspekte të tjera të specifikimeve teknike, të dhëna nga Autoriteti Kontraktor, me përjashtim të rasteve kur gabimi ishte aq i dukshëm sa kontraktori duhet ta kishte vënë re dhe ta kishte reklamuar këtë të Autoriteti Kontraktor.
- 13.3 Kodet dhe standartet që do zbatohen do të jenë të shprehura në dokumentat e tenderit. Nëse gjatë ekzekutimit të kontratës, ka ndryshime në zbatimin e kodeve ose standarteve, këto ndryshime do të zbatohen vetëm pasi të jenë aprovuar nga Autoriteti Kontraktor.

**Neni 14: Ekzekutimi i Punimeve**

- 14.1 Kontraktori duhet të fillojë zbatimin e kontratës menjëherë sapo ta lidhe atë dhe duhet t'i mbarojë Punët brenda Afatit të Mbarimit.

**Neni 15: Ngritja e Kantierit**

- 15.1 Kontraktori mban përgjegjësi për projektin e Ngritjes së Kantierit.
- 15.2 Kontraktori duhet të paraqesë të gjitha planet për Ngritjen e Kantierit tek drejtuesi i projektit për shqyrtimin dhe miratimin e tij.

**Neni 16: Sigurimi Teknik dhe Mjedisor**

- 16.1 Kontraktori do të mbajë përgjegjësi për sigurinë e të gjitha aktiviteteve në kantier.
